Irena Paradzhik Kovaçiq
Vanja Zidar Shmic

Secili kundër secilit

Studimi i rastit të Sllovenisë

Pyetja kyçe

Si e thelloi situata e luftës ndarjen politike mes sllovenëve?

Tema
Moduli ka të bëjë me luftën civile në Slloveni dhe mund të zbatohet në çdo regjion tjetër të ish Jugosllavisë. U dedikohet fëmijëve / nxënësve nga mosha 14 deri në 18 vjeç. Kjo është periudha e luftës së dytë botërore. Ne e zgjodhëm këtë temë sepse është mjaft kontroverse dhe e ndjeshme për tërë hapësirën e ish Jugosllavisë, sepse pas më tepër se 60 viteve ende ekzistojnë ndarje në mesin e njerëzve dhe politikanëve duke e pasur parasysh këtë periudhë dhe pajtimi nuk është arritur plotësisht ende.

Qëllimet
Nxënësit do të fitojnë dije për luftën civile në Slloveni.

Rezultatet e mësimit
1. Nxënësit do t'i krahasojnë përgjigjet e ndryshme të sllovenëve për okupimin.
2. Do të mësojnë pse rryma punëtore dhe borgjeze kishin përgjigje të ndryshme ndaj okupimit.
3. Do të kenë mundësi t'i njohin arsyet të cilat iniciuan forcimin e tensioneve të cilat shkaktuan konflikt mes sllovenëve.
4. Do të kenë mundësi të shprehin mendimin kritik në mënyrë konstruktive dhe të ballafaqohen me historinë e ndjeshme dhe kontroverse.

Udhëzime për mësimdhënësin

Mësimdhënësi do t'ua lexojë hyrjen nxënësve dhe do t'ia parashtrojë temën klasës. Punëtoria ka dy pjesë – pjesa e parë (45 minuta) është punë në grupe, ndërsa pjesa e dytë (45 minuta) është prezantimi i rezultateve të secilit grup dhe debat.

90 minuta

Orientimi kohor:
HAPI 1: Mësimdhënësi i ndan nxënësit në 4 grupe:

Grupi 1: PËRGJIGJA NDAJ OKUPIMIT DHE POLARIZIMI, KISHA MES DY ZJARREVE.
Grupi 2: NJËSITË USHTARAKE: RRYMA E PUNËTORËVE – PARTIZANËT, BORGJEZIA – ÇETNIKËT SLLOVENË (BRIGADAT E KALTRA).
Grupi 3: NJËSITË USHTARAKE: BORGJEZIA – GARDA FSHATARE (MVAC), MBROJTËSIT E VENDIT.
Grupi 4: VËLLAI KUNDËR VËLLAIT (LUFTA QYTETARE 1942-1945)

HAPI 2: Mësimdhënësi u jep nxënësve udhëzime për punë në grupe (MËSIMI BASHKËPUNUES). Secili grup gjithashtu i merr këto udhëzime të printuara.

METODOLOGJIA – MËSIMI BASHKËPUNUES
Secili anëtar i grupit e merr fjetën e tij të punës, i zgjidh të gjitha detyrat dhe i shkruan përgjigjet. Secili anëtar i grupit zgjedh numrin nga 1 deri në 4, sepse secili prej tyre mund të zgjidhet si raportues pasi që grupi të përfundojë me punën. Krahas zgjidhjes së detyrave, secili anëtar i grupit do të ketë edhe një detyrë të rëndësishme. Secili grup duhet të ketë: **UDHËHEQËS, ROJTAR, KONTROLLUES TË KOHËS** dhe **VËZHGUES**.

Ndarja e roleve brenda grupit:	Komunikimi brenda grupit:
UDHËHEQËSI udhëheq me punën e grupit, verifikon nëse secili i kupton udhëzimet. Ai / ajo i lexon burimet e shkruara.	A lexoj mjaft kuptueshëm? A mund të formulojmë një përgjigje më të mirë?
ROJTARI siguron që të gjithë anëtarët të marrin pjesë. Ai / ajo i paralajmëron ato anëtarë që e kanë distancuar veten nga tema ose që nuk marrin pjesë.	Duhet të flisni ngadalë. Ne jemi tepër të zhurmshëm. Ti je gjithashtu anëtar i grupit tonë, andaj duhet të marrësh pjesë, sepse do të vlerësohemi si grup.
KONTROLLUESI I KOHËS e përkujton kufizimin e kohës, inkurajon të shpejtohet.	Shpejtoni, kanë mbetur edhe tre minuta. E kemi tejkaluar kohën, duhet të gjithë të bëjmë përpjekje.
VËZHGUESI vëzhgon si punon grupi.	Në fund ai / ajo raportojnë për punën e grupit dhe për të tria rolet tjera.

90 minuta

HAPI 3: Mësimdhënësi ua prezanton hyrjen e këtij moduli (temën) nxënësve. Secili grup gjithashtu e merr të printuar këtë hyrje.

HAPI 4: Nxënësit punojnë në grupe. Secili grup i analizon burimet historike dhe u përgjigjet pyetjeve në të njëjtën kohë. **Secili grup gjithashtu merr fjalor me të gjitha njësitë e ndryshme ushtarake dhe udhëheqësit e tyre ushtarakë.**

HAPI 5: Mësimdhënësi zgjedh për secilin grup nga një numër mes 1 dhe 4, kështu që ai merr nga një raportues për një grup. Raportuesi i prezanton burimet e përdorura historike pranë nxënësve të tjerë dhe i lexon përgjigjet ndaj pyetjeve. Në të njëjtën kohë nxënësit e vizatojnë shiritin e kohës dhe në tabelë i paraqesin grupet politike me të gjitha njësitë e tyre ushtarake gjatë kohës së okupimit.

HAPI 6: Mësimdhënësi e udhëheq debatin duke i shfrytëzuar pyetjet për të menduarit kritik. Ato pyetje për mendim kritik janë:

-A ishte i tepruar ose legjitim reagimi i civilëve që të përfshihen në Gardën Fshatare, Çetnikët dhe Mbrojtësit e Vendit?
-Cilat arsye ishin më bindëse që të përfshihen njerëzit në njërën rrymë apo në rrymën tjetër?
-Cilat ishin pasojat e vendimeve të njerëzve të asaj kohe për jetën në Sllovenínë bashkëkohore?

Pas përgjigjes ndaj këtyre pyetjeve kthehemi në pyetjen kyçe dhe bëjmë konkluzion final.

HYRJE PËR TËRË REGJIONIN

Si e thelloi situata e luftës ndarjen politike mes sllovenëve? (pyetja kyçe)

Në vjeshtën e vitit 1942, gjenerali italian Vittorio Ruggero i tha fjalët në vijim në një bisedë me ipeshkvin e Lubjanës:
"MVAC u ndihmoi shumë italianëve, por krijoi urrejtje të tillë në mesin e sllovenëve saqë nuk do të arrini ta mënjanoni as për 50 vjet"

Jan, Ivan: Korenine zla. Odstrte zavese I. Samozaložba. Ljubljana 1995. str. 13.

Më 6 prill 1941 trupat gjermane e sulmuan Jugosllavinë nga Bullgaria dhe Austria. Sulmi filloi me bombardimin e aeroporteve dhe caqeve të tjera ushtarake, si edhe qyteteve. Sulmi ndaj Beogradit ishte shkatërrues. Më njëmbëdhjetë prill, pasi që gjermanët depërtuan në Zagreb dhe Karllovac dhe e shkëputën perëndimin e Jugosllavisë nga qendra e saj, italianët e filluan invadimin e Sllovenisë dhe Kroacisë. Në atë kohë, ofensivën e filluan edhe trupat hungareze. Qeveria jugosllave dhe mbreti e lëshuan vendin i cili kapitulloi më 17 prill. Shumica e ushtrisë jugosllave ishte e zënë rob, duke e lënë vendin të ndarë.

Repe, B.: Sodobna zgodovina, učbenik za 4. letnik gimnazij. Ljubljana: Modrijan 2007. str.. 140

Ndarja e Jugosllavisë në zona okupimi



Gabrič, A. in Režek, M.: Zgodovina 4: Učbenik za 4. letnik gimnazije. Ljubljana: DZS 2011. str. 166.

Jugosllavia ishte e ndarë në dhjetë zona të cilat nuk formonin asnjë tërësi, por kishin statuse të ndryshme. Ndarja ishte bërë me qëllim të promovimit të shovinizmit mes popujve dhe nacionaliteteve të cilët në atë kohë jetonin në Jugosllavi.

Petranović, B.: Istorija Jugoslavije, knjiga II – Narodnoosvobodilački rat i revolucija. str.. 26 – 27. www.znaci.net/00001/96.htm

Një pjesë e Sllovenisë (Korushka e Epërme, Shtajerska dhe një pjesë e Prokmurjes), Banati, zona e xeheroreve rreth Borit me rrethinën e Serbisë së Vjetër ranë nën sundimin e Gjermanisë.

Petranović, str. 25 - 26

Hungaria e morri pushtetin në Prekomurje, Baranjë, Bačkë dhe Megjumurje, Bullgaria e pushtoi pjesën më të madhe të Maqedonisë, një pjesë të Kosovës dhe Serbinë juglindore, ndërsa italianët e morën tërë Sllovenine (të ashtuquajturën krahinën e Lubjanës), pjesën perëndimore të bregdetit kroat, bashkë me ishujt, Dalmacinë nga Zara deri në Split, një pjesë të ishujve dalmatë, Gorski Kotar, Malin e Zi, pjesën më të madhe të Kosovës dhe Metohisë, pjesën e Maqedonisë Perëndimore dhe Boka Kotorin. "Shqipëria e Madhe" e mori një pjesë të Metohisë dhe Kosovës si dhe pjesën perëndimore të Maqedonisë, një pjesë të Sanxhakut dhe pjesën lindore të Malit të Zi.

Repe, 1995, str. 135

Kroacia dhe Bosnja dhe Hercegovina u bënë pjesë e shtetit të pavarur të Kroacisë (NDH). Gjermanët, italianët, bullgarët dhe hungarezët filluan t'i denacionalizojnë territoret e okupuara dhe të kontrolluara të Serbisë, Sllovenisë, Maqedonisë dhe Kroacisë.

Petranovi , str. 36, 42

Regjimi më i rreptë ndaj sllovenëve ishte ai gjerman, i cili i ndaloi gazetat sllovene, shoqatat dhe organizatat. Nëpër shkolla dhe çerdhe njerëzit kishin mundësi të flisnin vetëm në gjuhën gjermane. Sllovenët ishin të detyruar të bëjnë migrime masive në vendet tjera, ndërsa ato vende i popullonin gjermanët. Njëjtë të dhunshëm ishin hungarezët në Prekomurje. Italianët në fillim nuk ishin ashtu të dhunshëm. E lejonin ekzistimin e institucioneve kulturore dhe arsimore sllovene.
Bullgarët, të cilët i zëvendësuan trupat gjermane në Maqedoni, e ndaluan përdorimin e emrit maqedonas, gjuhës dhe simboleve në tekstet zyrtare dhe i vendosën zyrtarët dhe priftërinjtë e tyre. Të rinjtë maqedonas ishin të detyruar të paraqiten në grupe të ndryshme bullgare fashiste dhe paramilitare dhe organizata nacionaliste rinore. /../ Kolonët dhe serbët të cilët në Maqedoni erdhën pas vitit 1918, u dëbuan, ndërsa prona e tyre u konfiskua... Gjuha italiane dhe shqipe u shpallën si gjuhë zyrtare në Maqedoninë Perëndimore; teoria për prejardhjen shqiptare të maqedonasve doli në pah. Partia Fashiste Shqiptare (PFSH), e cila përbëhej prej shqiptarëve dhe rinisë turke, e promovonte urrejtjen ndaj maqedonasve. Bullgarët e sqaronin ekspansionin e tyre në territorin e Serbisë si të drejtën e tyre natyrore, sepse pohonin se Morava është lum bullgar.
Serbët migruan nga NDH, Kosova dhe Metohia. Deri në mbarimin e luftës, Serbia ofronte strehim për 240.000 refugjatë serbë (dhe sllovenë), të cilët më herët migruan nga pjesët e tjera të Jugosllavisë. Megjithatë, studimet e reja pohojnë se ky numër ishte deri në 400.000 /.../. Forma më e ashpër e denacionalizimit ishte në NDH, që ishte i njohur për holokaustin, gjenocidin ndaj serbëve, hebrenjve dhe romëve.

Petranović, str. 42, 43)

Një grup partizanësh

Povijesni muzej Istre

LUFTA CIVILE
Konfliktet e ndërsjella u shkaktuan nga konfliktet etnike dhe fetare, bashkëpunimi me okupatorin dhe interesin e komunistëve që të futen në luftë kundër armikut të klasave në patronazhin e Lëvizjes Nacionalçlirimtare. Rrënjët e konfliktit depërtonin deri në ndarjet e paraluftës të cilat vetëm se u thelluan gjatë luftës.

LËVIZJA ÇLIRIMTARE NË JUGOSLLAVI
Lëvizja Çlirimtare Jugosllave (Partizanët), me përjashtim të asaj sovjetike, ishte më e fuqishmja në Evropë. Për shkak të organizatave të tyre ilegale, komunistët ishin të vetmit të cilët e mbajtën rrjetin politik në tërë territorin e ndarë të Jugosllavisë. Ata organizuan rezistencë dhe operacione vetjake të cilat e tërhoqën popullin që t'i bashkëngjitet lëvizjes masive dhe inicimit të revolucionit.
Politikanët të cilët nuk kishin ikur nga vendi pas shpërthimit të luftës, dëshironin që së paku formalisht ta mbajnë pozitën duke bashkëpunuar me okupatorin ose duke e pritur pasivisht çlirimin. Meqenëse Jugosllavia ballafaqohej me krizë serioze ekonomike dhe politike para luftës dhe meqenëse popujt e caktuar dhe pakicat ishin në pozitë të pabarabartë, njerëzit lëvizjen e rezistencës e kuptonin si mundësi për regjim tjetër të pasluftës dhe si mjet për heqjen e padrejtësisë nacionale dhe sociale. Për shkak të sistemeve të ndryshme të okupimit dhe interesave të popujve të caktuar, lëvizja jugosllave e rezistencës ishte mjaft e larmishme.
Krahasuar me çetnikët, ustashët dhe të tjerët, partizanët ishin shumë më të disiplinuar, por as atyre nuk u mungonte nevoja për hakmarrje, konfrontime të ndryshme, tortura dhe masakrime ndaj civilëve. Për dallim prej kundërshtarëve të tyre, hapat e theksuar nuk ishin pjesë e "mënyrës e luftës" zyrtare. Reputacioni i luftës nacionalçlirimtare ra për shkak të hakmarrjeve të paligjshme masive me anëtarët e formacioneve kuislingë pas luftës.

Repe, 1995, str. 157

LËVIZJA ÇETNIKE – Emri është krijuar nga fjala *çetë*, *çetëzim* dhe rrjedh nga periudha kryengritjes dhe luftës gjatë Perandorisë Osmane. Lëvizje kishte përkrahjen e plotë të aleatëve perëndimorë deri në fund të vitit 1943. Duke e pasur parasysh që flisnin në dobi të mbrojtjes dhe bashkëpunimit me okupatorët në pritje të ndryshimeve në frontet botërore, taktika e tyre luftarake dallonte nga ato partizane.

Më vonë iu bashkëngjitën luftës, duke paramenduar se bashkëpunimi i tyre me pushtuesit do të harrohet. Strategjia e tyre ishte e drejtuar nga dominimi i serbëve në Jugosllavinë e rindërtuar dhe qërim hesapesh me kroatët dhe pakicat, sepse i konsideronin si fajtorë kryesorë të humbjes së Mbretërisë dhe vuajtjeve të serbëve. Ishin për ideologjinë e Serbisë së Madhe etnikisht të pastër me dalje në det, edhe pse lejonin edhe lidhje federative me Kroacinë e zvogëluar në Jugosllavi. Udhëheqësi i tyre, Dragoljub Mihailoviq, ishte ministër i luftës në qeverinë e mërguar dhe komandant i ushtrisë jugosllave në vendlindje. Gjatë vitit 1941 dy herë zhvilloi bisedime me Titon për mundësinë e luftës së përbashkët, edhe pse të dyja palët tanimë kishin shijuar konflikte të ndërsjella (humbja e çetnikëve në Ravna Gora). Në nëntor të vitit 1941 udhëheqësit çetnikë u pajtuan që të luftojë kundër gjermanëve dhe e refuzuan kërkesën sipas së cilës partizanët duhej të bëhen pjesë e njësive çetnike, por nuk iu përmbajtën kësaj marrëveshjeje. Një pjesë e çetnikëve në mënyrë sporadike luftonte kundër gjermanëve ndërsa i sulmonin nga afërsia e territoreve partizane, prandaj gjermanët u hakmerreshin familjeve partizane, ndërsa pjesa më e vogël e çetnikëve iu bashkëngjit partizanëve. Konfrontimet u ritën në luftë qytetare, kështu që në disa periudha partizanët e konsideronin luftën kundër çetnikëve si mision parësor të tyre. Çetnikët ishin të përçarë dhe refuzonin ta lëshojnë territorin e tyre; u mungonte edhe disiplina dhe ishin brutalë ndaj civilëve dhe të burgosurve.

Çetniku Mico

Foto kolekcija historijskog muzeja BiH, broj inventara133

Çetnikë, Bijelinë

Foto kolekcija historijskog muzeja BiH, broj inventara 129

Eugen Dido Kvaternik (në të djathtë), shefi i RASVIGUR (komisar i rendit dhe i sigurisë publike nga vitit 1941 deri në vitin 1943)

USTASHËT DHE SHTETI I PAVARUR I KROACISË (NDH)

Shteti i Pavarur i Kroacisë është shpallur më 10 prill 1941. E shpalli koloneli i ustashëve Sllavko Kvaternik. Udhëheqës i ustashëve ishte dr. Ante Paveliq. NDH ishte plotësisht e varur nga udhëheqësit gjermanë dhe vazhdimisht ishte në kufijtë e mbijetesës për shkak të partizanëve dhe interesimit të italianëve për territorin e tyre, veçanërisht Bosnjës dhe Hercegovinës. NDH ishte shtet ekstrem katolik. Legjislacioni ishte nacionalist, racist dhe armiqësor ndaj serbëve, hebrenjve, romëve dhe komunistëve. Myslimanët nuk ishin të pranuar si komb dhe llogariteshin si kroatë, si edhe sllovenët, për të cilët thuhej se janë "kroatë nga Alpet". Njësitë ushtarake të NDH-së përfshinin mbrojtës të vendit, ustashë, policë të armatosur dhe forca të rendit dhe sigurisë. Njësitë e ustashëve ishin ushtri partiake, në krye me strumbullarin e ustashëve dhe Paveliqin si udhëheqës. Disa njësi ishin veçanërisht të vrazhda, ngjashëm si edhe policia nën komandën e djalit të Kvaternikut, Gvidos. Mbrojtësit e vendit ishin ushtri këmbësorie me një pjesë të vogël të marinës dhe flotës ajrore. Një pjesë e mbrojtësve të vendit luftonin në frontin e lindjes dhe kryesisht u vranë në betejën e Stalingradit.

Ustash

Foto kolekcija historijskog muzeja BiH, broj inventara 137

Fraksioni borgjez

Burimi **1**

Bani*, Marko Natlaçen, u bën thirrje sllovenëve dhe qytetarëve të Lubjanës në Kuvendin Popullor të Sllovenisë, më 11 prill 1941, të mbeten të qetë edhe pse e presin okupimin.

Sllovenë! Qytetarë të Lubjanës!
Lubjana, kryeqyteti i Sllovenisë, së shpejti do të okupohet. Në këtë moment, ne duhet taruajmë rendin dhe paqen të cilat janë tiparet tona! Duhet të mbetemi të përmbajtur, të fokusuar, të disiplinuar dhe trashëgimtarë fetarë të të parëve tanë! Ta tregojmë dinjitetin tonë në mënyrë dinjitoze dhe të qetë!
Kombi na është ekspozuar ndaj dy kërcënimeve më të mëdha. Tani, kur ushtria jonë na la neve, mëkati më i madh në popull do të ishte nëse civilët do t'i merrnin armët kundër ushtrisë së huaj ose kundër pakicave nacionale, ose nëse do të vepronit kundër tyre në çfarëdo forme tjetër armiqësore. Nëse do të vepronim kështu, qindra familjarë tanë do të ekspozoheshin ndaj rrezikut të madh dhe vështirësive.
Mëkati tjetër do të ishte dënimi publik, i cili nuk është në përputhje me dinjitetin njerëzor. Dënimi publik është mëkat aq i rëndë saqë populli asnjëherë nuk do ta falë. Sipas kësaj, mos lejoni që dënimi publik të ngrihet mes nesh.
Përfaqësuesit e pushtetit shtetëror dhe publik do të mbeten në pozitat e tyre dhe do të veprojnë përderisa nuk urdhërohet ndryshe. Ligjet e njëjta janë në fuqi përderisa nuk urdhërohet ndryshe. Çdo ndryshim do të shpallet.
Ligjet duhet të respektohen pa kusht!
Rendi dhe qetësia publike nuk guxojnë askund të prishen! Le të tregohet disiplina jonë në këtë moment të vështirë!
Mos ikni, qëndroni dhe duroni!

*Bani dhe Kuvendi Popullor i Sllovenisë *Bani ishte titulli i Udhëheqësit lokal, provincial, i emëruar nga qeveria qendrore

Slovenski dom, leto VI., št. 83, petek 11. aprila 1941

Fraksioni i punëtorëve

Burimi **2**

Pikat fondamentale të Frontit Çlirimtar, të shpallura më 22 qershor 1941, në ditën e invadimit gjerman të Bashkimit Sovjetik.

1. Duhet të organizohet aksion i pamëshirshëm i armatosur kundër pushtuesit.
2. Aksionet shërbejnë si pikë fillestare për çlirim dhe bashkim të të gjithë sllavëve.
3. Në bazë të bashkësisë së natyrshme të popujve sllavë, Fronti Çlirimtar (FÇ) nuk e pranon ndarjen e Jugosllavisë dhe me të gjitha forcat lufton për bashkim dhe barazi të të gjithë popujve. Njëkohësisht FÇ synon lidhjen e popujve sllavë nën popullin e madh rus, në bazë të të drejtës së secilit popull për vetëvendosje.
4. Në bazë të aksioneve për çlirim dhe aktivizim të masave sllave, FÇ e riformëson karakterin nacional slloven. Masat sllovene, duke luftuar për të drejtat nacionale dhe njerëzore, krijojnë karakter të ri të sllovenizmit aktiv.
5 Të gjitha grupet të cilat bashkëpunojnë brenda FÇ janë të obliguara të mbajnë raporte të ndërsjella luajale.
6 Pas çlirimit kombëtar, pushteti do të jetë në duart e Frontit Çlirimtar si tërësi.
7. Pas çlirimit kombëtar, FÇ do të vendos demokraci konsistente. Të gjitha çështjet të cilat e tejkalojnë kuadrin e çlirimit kombëtar, do të zgjidhen me ndihmën e demokracisë konsistente. /.../
8 Në përputhje me deklaratat solemne të Çerçilit, Ruzveltit dhe Stalinit, populli slloven do të vendosë për çështjet të cilat kanë të bëjnë me punët e brendshme dhe të jashtme. FÇ do t'i zbatojë dhe mbrojë të drejtat e përmendura elementare me të gjitha mjetet.
9. Ushtria popullore në territorin e Sllovenisë është e përbërë nga partizanët dhe mbrojtja popullore, të cilët apelojnë pranë të gjithë sllovenëve të vetëdijshëm.

Dokumenti ljudske revolucije v Sloveniji, knjiga I. 12 in 13/255-256, v: Slovenski poročevalec, 1. II. št. 24 (8. 11. 1941) in 1. III. št. 1 (6. 1. 1942)

Pyetje:

1. Krahasoji deklaratat e *Fraksionit borgjez dhe atij të punëtorëve.*
2. Përpiqu të sqarosh këndvështrimet e tyre për *rezistencën* ndaj okupimit.

Kisha mes dy zjarreve

Burimi **3**

Letër nga ipeshkvi i Lubjanës, Gregorij Rozhman komisarit të lartë E. Grazioli

Ekselencë!
Dekreti për aneksimin ndaj Italisë të territoreve sllovene të cilat i okupoi ushtria italiane, është lëshuar sot. Duke e marrë parasysh këtë, duhet t'i shpreh falënderim ekselencës Tuaj, sepse territori i dioqezës mundëson zhvillim të madh në aspektin kulturor dhe fetar, kështu që presim të formësojmë autonomi të jetës kombëtare në kuptim të dekretit, në dobi të kishës dhe moralit. E shpreh përkushtimin tim të plotë dhe e lus Zotin t'ju bekojë Juve dhe të gjitha përpjekjet tona për të mirën e popullit tonë.

Griesser – Pečar, Tamara: Razdvojeni narod. MK. Ljubljana 2004. str.. 180.

Burimi **4**

Letër pastorale e ipeshkvit të Lubjanës, Gregorij Rozhman, në fund të tetorit 1941. Ai flet për qëndrimin e papës dhe kishës katolike për komunizmin.

Çështja, të cilën e sqaroi dhe e urdhëroi (Shkof. List 1937, f. 39-59) papa Piu XI në letrën qarkore "Divina Redemptoris", nga 19 marsi 1937, është e rëndësishme për ne. Në të ai deklaron: "Komunizmi për nga natyra e tij, e kundërshton çdo religjion" (pika 22), "Komunizmi është diçka që në thelbin e tij është i keq, kështu që asnjë person i afërt me krishterimin nuk duhet të bashkëpunojë me të" (f. 58). Parimet e papës zbatohen ndaj nesh, prandaj për to nuk do të diskutojmë por do t'u përmbahemi sipas ndërgjegjes dhe njohurive tona. Të presësh zhvillim të caktuar kulturor apo bile liri kombëtare nga komunistët është gabim tërësisht fatal, i cili do ta dënojë popullin në robëri më të keqe dhe do ta zhdukë.

Weber, T., Novak, D.: 20. stoletje v zgodovinskih virih, besedi in slikah. Druga svetovna vojna v Sloveniji in Jugoslaviji. DZS. Ljubljana 1998. str.. 49.

Pyetje:

Sqaroje qëndrimin e ipeshkvit të Lubjanës, Gregirij Rozhman, ndaj okupatorëve italianë dhe arsyet e veprimeve të tija.

Burimi **5**

Qëndrimi i klerit ndaj Frontit Çlirimtar

FÇ është organizatë e dënuar nga ana e Ipeshkvit si institucion antikombëtar dhe antikatolik. Katoliku nuk guxon të merr pjesë në të, as ta ndihmojë në cilëndo qoftë mënyrë... Nëse ata, të vetëshpallur, e kërcënojnë lirinë dhe lëvizjen e njerëzve, ose i imponojnë iluzionet e tyre, ose i detyrojnë njerëzit të dalin në mal, çdo vetëmbrojtje fizike si edhe mbrojtje e organizuar prej tyre është e lejuar. Ashtu siç individi mund të mbrohet nga dhunuesi i padrejtë, në mënyrë të njëjtë fshati ose vendbanimi mund ta mbrojë veten. Nga ana tjetër, do të ishte mëkat të organizohet marsh në male për shkak të shkatërrimit të banditëve të cilët fshihen atje. Duke vepruar kështu, do të ekspozohemi ndaj rrezikut, do t'i kishim mbaruar jetët e shumë individëve të pafajshëm ose të lënë pas dore.

Cerkev in revolucija OF, zbornik SAZU, Slovenski upor 1941.

Burimi **6**

Ipeshkvi Gregorij Rozhman me komandantin e Mbrojtësve Sllovenë të Vendit gjeneralin Leon Rupnik dhe gjeneralin SS Ervin Rösener në stadiumin e Lubjanës para ceremonialit të betimit.



Jan, Ivan: Odstrte zavese. Okupator in gorenjsko domobranstvo. Društvo piscev zgodovine NOB Slovenije. Ljubljana 1992. str.. 57.

Pyetje:

Cili ishte qëndrimi i shumicës së klerit ndaj Frontit Çlirimtar në regjionin e Lubjanës?

Burimi 7

Ushtrimi i detyruar për priftërinjtë e paraburgosur në kazermën "Mevlje" në Maribor.

Në maj të vitit 1941, 1.300 sllovenët ishin në llogore anekënd Sllovenisë. Rreth 130 prej tyre ishin priftërinj. Këta priftërinj ishin të detyruar në ushtrime fizike, mbylleshin nëpër bunkerë dhe riheshin.

Raziskujem preteklost 9. Delovni zvezek. Rokus. Ljubljana 2005. str. 96.

Burimi 8

Pas mbledhjes së partizanëve përballë Shtëpisë së Kulturës në Prezid, më 14 tetor 1943: zyrtari fetar i divizionit të 14-të Jozhe Lampret i shoqëruar nga prifti Franjo Posh.

Kržišnik, Zvone: Patrulja zvestobe. Kulturniška skupina 14. divizije. Založba Borec in Partizanska knjiga. Ljubljana 1984. – foto: Jože Petek, fotoreporter 14. divizije.

Burimi 9

Nga fjalimi i Bozhidar Gorjan – Bog

në përvjetorin e 65-të të çlirimit të luginës së Savinjës së Epërme, publikuar më 20.02.2011.

/.../ nuk do të flas për brigadat ose për popullin tonë të guximshëm, në lidhje me kujtimet e sotme të çlirimit të Savinjës para 65 viteve. Megjithatë, do ta përmend jetën dhe veprën e dy priftërinjve të rëndësishëm nga Shtajerska: JOZHE LAMPRET ishte zyrtar fetar në divizionin e 14-të, ndërsa Franc Shmon kishte rolin e njëjtë në grupin e 14-të operativ për regjionet Shtajerska dhe Korushka. Bota e pa fotografinë e Lampretit, me veshjen e parehatshme të priftit, si i bart të plagosurit. Ai paraqet përpjekje të madhe njerëzore dhe vuajtje, përkushtuar shpëtimit të jetëve njerëzore, ndërsa në mënyrë simbolike edhe kombit slloven. Po, bile edhe priftërinjtë ishin në anën e Frontit Çlirimtar, në anën e partizanëve, duke e shpëtuar fatin e popullit slloven. Personalisht i njihja që të dy, dhe ndjehem i obliguar të flas për jetët e tyre fisnike. Me veprimtarinë e tyre fetare, ata shpirtërisht e pasuruan luftën tonë. /.../ Pushtuesit u munduan ta shtypin sllovenizmin në Shtajerskë, duke i përndjekur priftërinjtë sllovenë. Lufta për të drejtën e fesë në gjuhën amtare u bë pjesë përbërëse e lëvizjes çlirimtare. /.../ Besimtarët vuanin për shkak të mungesës së shërbimit fetar slloven. Për këtë arsye pesha e priftërinjve partizanë ishte edhe më e madhe. Lufta e tyre e vetmuar kërkonte sakrifica mbinjerëzore. Moral dhe ngushëllim ofronin komisarët, ndërsa priftërinjtë partizanë kujdeseshin për çështjet e fesë. Përveç punës nëpër njësite, priftërinjtë ofronin strehim për fshatarët në hapësirat ku partizanët kishin kulm mbi kokë. /.../

www.zb-nob-solcava.si/2011/02/govor-bozidarja-gorjana-boga-ob-65-obletnici-osvoboditve-zgornje-savinjske-doline/ (10. 5. 2013)

Pyetje:

1. *Cila ishte pozita e klerit katolik në sistemin okupues gjerman?*
2. *A punonin të gjithë priftërinjtë sipas qëndrimeve të Vatikanit?*
3. *Pse disa priftërinj bashkëpunonin me Lëvizjen Nacionalçlirimtare?*

FRAKSIONI I PUNËTORËVE – PARTIZANËT

Burimi **1**

Dy partizanë, Jozhe Simshiq – Jelen dhe Dane Matko – Matija (Gornje Jezero, pranverë 1944)

http://stareslike.files.wordpress.com/2012/01/120107002.jpg (10. 5. 2013)

Burimi **2**

Pjesë nga ligji i partizanëve

Neni 1

Njësitë partizane i përbëjnë vullnetarët – partizanët të cilët dëshirojnë të luftojnë në mënyrë luajale dhe këmbëngulëse, me armë në dorë, kundër okupatorëve fashistë, për qëllimin e madh të çlirimit të sllovenëve dhe të drejtat e popullit punues. Ata janë në kontakt të afërt me masat sllovene dhe të gjithë popujt, luftojnë kundër bandës fashiste, duke u mbështetur në aksionet operative dhe ushtarake të të njohurës Armatës së Kuqe punëtore-fshatare të Bashkimit Sovjetik... Partizanët nuk do të ndalen përderisa qëllimet për të cilat janë çuar me armë në dorë nuk plotësohen.

Neni 2

Njësitë partizane e pranojnë çdo njeri, pa e marrë parasysh besimin politik dhe përkatësinë nacionale, i cili i pranon qëllimet e përmendura, i cili nuk ka moral të prishur dhe i cili e pranon këshillin rekrutues partizan. Bashkëngjitja me partizanët do të thotë që partizani e përkushton të gjithë fuqinë dhe jetën për çlirimin e sllovenëve dhe popullit punues.

Neni 3

Zbatimi i detyrave partizane do të zgjasë deri në fitoren përfundimtare të luftës për çlirim të popullit slloven. Partizani mund të lirohet nga detyrat e tija revolucionare vetëm në rast të sëmundjes ose vdekjes. Për t'u bashkëngjitur partizanëve, individi duhet të pajiset mirë me veshje, këpucë, veshje të brendshme, batanije, ushqim për një javë, dhe nëse është e mundshme me armë. Është e dëshirueshme që me vete të ketë harta, busull, dylbi, material të nevojshëm sanitar dhe gjësende të tjera të nevojshme.

Zbornik dokumentov in podatkov o narodnoosvobodilni vojni jugoslovanskih narodov, del VI. knjiga 1/5 Ljubljana 1956.

Burimi **3**

Betimi i partizanëve

Unë, partizani i ushtrisë çlirimtare të popullit slloven, i cili lufton bashkë me Ushtrinë e Kuqe të Bashkimit Sovjetik dhe të gjithë popujt e tjerë që luftojnë për liri, luftoj për çlirimin dhe bashkimin e popullit slloven, për vëllazëri dhe paqe mes popujve dhe ardhmëri më të mirë të popullit punonjës dhe betohem para popullit tim dhe bashkëluftëtarëve: Se do të jap çdo gjë që është në fuqinë time për lirinë e popullit slloven, klasës punëtore dhe për njerëzimin përparimtar dhe liridashës në luftën e shenjtë kundër fashistëve dhe banditëve, dhe nuk do t'i harroj radhët e partizanëve, të cilëve iu bashkëngjita vullnetarisht dhe me vetëdije, dhe nuk do ta dorëzoj armën time deri në fitoren përfundimtare mbi fashistët dhe realizimit të plotë të qëllimit të madh për liri të popullit slloven.
Në luftën për qëllimet e mëdha çlirimtare, betohem se do t'i mbroj nderin dhe pacenueshmërinë e flamurit tonë partizan me gjakun tim dhe nëse ka nevojë, do ta jap jetën time.

Zbornik dokumentov in podatkov o narodnoosvobodilni vojni jugoslovanskih narodov, del VI. knjiga 1/5 Ljubljana 1956

Burimi **4**

Poeti dhe partizani slloven Matej Bor e përshkruan armikun e tij në poezinë "Hej brigadë"

Hej brigada
Hej brigada, shpejtoni,
shkatërroni dhe digjni
foletë e dreqërve të bardhë dhe të zinj,
Hej mitraloz...

Matej Bor, Hej brigade. Iz borb in življenja prvih štirih slovenskih brigad, september 1952

Pyetje:

1. Me ndihmën e burimeve të ndryshme, përpiqu të përcaktosh kush kishte mundësi t'u bashkëngjitet partizanëve dhe çka do të thoshte bërja partizan për individët.
2. Kujt i betoheshin partizanët dhe si ishte betimi?
3. Cili është mesazhi i këngës "Hej brigada"? Sqaroje kuptimin e këngës për atë kohë.

FRAKSIONI I PUNËTORËVE – PARTIZANËT

Burimi **5**

Komandanti i çetnikëve sllovenë Karel Novak raporton pas kthimit nga takimi me Drazha Mihailloviqin në Ravna Gora (1941)

Menjëherë pas kësaj, udhëtova në Serbi me kolonelin Avshiq. Organizata e Beogradit nën udhëheqjen e majorit Todoroviq siguroi dokumente të falsifikuara. Pas disa sukseseve të mëdha të përbashkëta kundër gjermanëve, Serbia përjetoi sulm tradhtar ndaj çetnikëve. Pas mbledhjes dhe raportit të kolonelit Mihailloviq, ai na dha miratim me shkrim për veprim; Avshiq si komandant dhe unë si kryesues i shtabit të JVVD (Ushtrisë jugosllave në vend në hapësirën e Sllovenisë). U larguan nga Ravna Gora dhe u kthyem në Sllloveni, ku komunistët tanimë kishin filluar propagandë të fuqishme kundër çetnikëve. Unë ndërpreva lidhjet me Frontin Çlirimtar, dhe pastaj Radovan Avshiq dhe tre ministrat e dikurshëm dhe bani kaluan te komunistët dhe e shfrytëzuan miratimin e Mhailloviqit. Kjo ishte arsyeja për shkak të së cilës shumica e oficerëve aktivë i kundërvihej vendimit të tyre.
Për mua, rruga ishte e qartë: të veprohet për mbretin dhe Jugosllavinë, të organizohen forca ilegale ushtarake, të luftohet kundër armikut dhe të merret qëndrimi mbrojtës ndaj partizanëve.

Tabor, št. 9 - 10, letnik 1982, str. 154 / Odporniško gibanje v Sloveniji 1941 – 1943, Iz arhiva podpolkovnika Karla Novaka, zastopnika Jugoslovanske vojske v domovini

Pyetje

1. *Nën komandën e kujt ishin çetnikët sllovenë dhe cilat ishin raportet e tyre me Frontin Çlirimtar?*

2. *Me ndihmën e burimeve përpiqu të kuptosh për cilat qëllime luftonin ata?*

Burimi **6**

Çetnik slloven

Jozhe Sinjur nga Dolenja Vas

Nose, Aleš: Domobranci zdravo – bog daj. Protikomunistične enote na Slovenskem 1942 – 1945). Modrijan. Ljubljana 2008. str. 31.

FRAKSIONI BORGJEZ – GARDA FSHATARE (MVAC)

Burimi **1**

Portret grupor i Gardës Fshatare. Gjysma e burrave janë veshur me uniforma të ngjyrosura italiane, ndërsa të tjerët me tesha civile. I pari nga e majta në rendin e parë ka simbol gjerman (Totenkopf) në beretë.



Nose, Aleš: Domobranci zdravo – bog daj. Protikomunistične enote na Slovenskem 1942 – 1945). Modrijan. Ljubljana 2008. str. 75 . – Zasebni arhiv

Burimi **2**

Freskë në vendin e rojës të Gardës Fshatare në Dravlje të Lubjanës

Nose, Aleš: Domobranci zdravo – bog daj. Protikomunistične enote na Slovenskem 1942 – 1945. Modrijan. Ljubljana 2008. str. 42. – Zasebni arhiv

Burimi **3**

Raport i kontabilitetit të komandës italiane për Lubjanën,
rreth 15.120 lira u janë ndarë anëtarëve të njësive MVAC – versioni italian



COMANDO DELLA DIVISIONE DI FANTERIA CACCIATORI DELLE ALPI
Ufficio del Capo di Stato Maggiore
Sezione Affari Civili

N° 2329/A.C. di prot. P.M.100, 14 gennaio 1943 - XXI°
OGGETTO: militi della formazione M.V.A.C. di STICNA.-

AL COMANDO XI CORPO D'ARMATA
Ufficio M.V.A.C.

P.M. 46

Nei giorni 15 e 18 dicembre u.s. due pattuglie della M.V.A.C di STICNA, composte di 8 e 9 uomini, traventiti da b.c., si sono locevolmente comportati uccidendo 4 b.c., tra cui il noto capo: HAUPTMAN Francesco.

Propongo pertanto un premio in denaro nella seguente misura:

- JAKOS Giovanni (esq.) L. 250 (ha preso parte alle due pattuglie)
- JAKOS Francesco " 200 " " " " "
- JANCAR Giovanni " 200 " " " " "
- BERTAN Antonio " 200 " " " " "
- GRCHAN Milan " 200 " " " " "

- ZAJFC Giuseppe " 150 (ha preso parte alla seconda pattuglia)
- KESTNIK Giuseppe " 150 " " " " "
- HAUPTMAN Vincenzo " 150 " " " " "
- SKUPCA Giuseppe " 150 " " " " "

- TEPIN Lodovico (esq.) " 150 (ha preso parte alla prima pattuglia)
- TEPIN Augusto " 100 " " " " "
- SEVER Carlo " 100 " " " " "

IL GENERALE COMANDANTE INT/LE
-Luigi Maggiore Perni-

COMANDO XI CORPO D'ARMATA
Ufficio M.V.A.C.
Data di arrivo

Weber, T., Novak, D.: 20. stoletje v zgodovinskih virih, besedi in slikah. Druga svetovna vojna v Sloveniji in Jugoslaviji. DZS. Ljubljana 1998. str. 65

Burimi **4**

Fragmenti flet për themelimin e Gardës Fshatare

Ja se si u themelua Legjioni nga ana e Savojit, më vonë u riemërua në "Militia Volontaria antikomunista". U mendua si Ushtria Popullore Sllovene e cila duhej ta mbrojë popullin. Fermerët kërkonin armë në të gjitha pjesët e krahinës së Lubjanës. Kështu që askush nuk detyronte fermerët t'i marrin armët në dorë. Nisma e tyre për vetëmbrojtje dhe dëshira për mbijetesë ishin arsyeja për veprim.

V službi domovine (s. n. 1945), str. 15

Pyetje

1. Cilat ishin disa nga detyrat e Gardës Fshatare?
2. Kujt i ndihmuan ata?
3. Kush i financonte ata?

Burimi **5**

Apel për themelimin e Mbrojtësve të Vendit Slloven në shtator të vitit 1943

Për shkak të tradhtisë së mbretit të Italisë dhe nguljes së thikës së tij në shpinën e mareshalit Badoglio, ushtria e Italisë më nuk ekziston. Pas tradhtisë së turpshme të klikës së Badoglios, situata është plotësisht qartë: Bile edhe atdheu ynë i dashur do t'u dorëzohet bolshevikëve me ndihmën e plutokracisë amerikane. Ndjekësit tradhtarë dhe bolshevikë zhvillonin luftë e cila i shtynte njerëzit e vlefshëm, të drejtë dhe besimtarë në vuajtje, dhunë, uri, plaçkitje dhe në rrugën e robotëve shekullarë dhe të pashpirt, si edhe ndihmësit e pandershëm në dobi të tiranisë botërore kundër hebrenjve.

AUSWEIS – IZKAZNICA

Der Schütze - domobranec
Dienstgrad Službena stopnja

Lavrič Anton
Vor- u. Zuname Priimek in ime

21. 10. 1923 Retje
geboren Datum in kraj rojstva
Dat. u. Ort)

Schütze domobranec
Dienstfunktion Službeno opravilo

Angehöriger je član Slovenskega
r Sloveni- domobranstva
en Landes- in je uslužben
hr und im v (na)
biete

Unterschrift — Podpis
Lavrič Anton

Höhe 165 Haare braun
višina lasje mava
Gestalt normal Augen braun

Genehmigt!

Der Höhere SS- u. Polizeiführer im Wehrkreis XVII

A. B.

LEUTNANT
~~Hauptmann~~ der Schutzpolizei

Dienststempel der Dienststelle
der Slowenischen Landeswehr
Pečat Slovenskega domobranstva

Unterschrift — Podpis

Burimi 7

Linja e parë e aradhes së 47-të në Cerknicë. I katërti nga e djathtë mban simbol antipartizan në xhepin e gjoksit.

Nose, Aleš: Domobranci zdravo – bog daj. Protikomunistične enote na Slovenskem 1942 – 1945). Modrijan. Ljubljana 2008. str. 152.

Burimi 8

Simbol antipartizan

Nose, Aleš: Domobranci zdravo – bog daj. Protikomunistične enote na Slovenskem 1942 – 1945). Modrijan. Ljubljana 2008. str. 194.

Burimi 9

Betimi i Mbrojtësve të Vendit

"Betohem në Zotin e gjithëfuqishëm që do të jem i guximshëm, i përkushtuar dhe i dëgjueshëm ndaj eprorëve të mi dhe me vetëdije do ta përmbushin detyrën time ndaj atdheut slloven si pjesë të Evropës së lirë, dhe që do të marr pjesë bashkë me forcat gjermane nën komandën e Gjermanisë së madhe, trupave SS dhe policisë, në luftën e përbashkët kundër banditëve dhe komunistëve dhe aleatëve të tyre. Për këtë luftë jam i gatshëm ta flijoj edhe jetën time. Pra Zoti më ndihmoftë!"

Slovenec, 21. 04. 1944

Fragment nga betimi i Mbrojtësve të Vendit

http://www.youtube.com/watch?v=V14a2rp5fAM (10. 5. 2013)

Pyetje:

1. Me ndihmën e burimeve përpiqu të sqarosh pse janë formuar mbrojtësit e atdheut slloven dhe kush i financonte ata.

2. Emëroji themeluesit e mbrojtësve të vendit slloven.

3. Përpiqu të sqarosh kujt i betoheshin mbrojtësit e vendit slloven për besnikëri dhe kundër kujt luftonin. Për ndihmë shfrytëzo tekstin e betimit të mbrojtësve të atdheut.

FORMIMI I FRAKSIONIT ANTIREVOLUCIONAR

Burimi **1**

Kartolinë përkujtimore e viktimave të Bizovikut dhe Dobrunjes, viktima të terrorit partizan të vitit 1942

Nose, Aleš: Domobranci zdravo – bog daj. Protikomunistične enote na Slovenskem 1942 – 1945. Modrijan. Ljubljana 2008. str. 92

Burimi **2**

Shërbimi i Sigurisë (VOS), që punonte brenda Frontit Çlirimtar, i përdorte vrasjet në Lubjanë dhe zonat përreth, dhe kjo e shtonte vijën ndarëse mes dy fraksioneve.

Vetëm në Lubjanë pjesëtarët e VOS-it kryen 49 sulme ndaj përfaqësuesve të jetës publike. Terrori komunist u zgjerua nëpërmjet tërë krahinës së Lubjanës sepse komunistët i vrisnin priftërinjtë, kryetarët e komunave, fshatarët e njohur, anëtarë të Aksionit Katolik, djem dhe vajza në fshat, persona të moshuar, fëmijë, por edhe familje të tëra – me një fjalë, secilin për të cilin dyshonin që bashkëpunon me bjellogardistët.

V znamenju osvobodilne fronte, Dokazila o grozodejstvih komunizma v Ljubljanski pokrajini, Ljubljana 1943 – XXI

Burimi **3**

Deklarata e komandës së aradheve partizane sllovene për bashkëpunimin me okupatorin

Komanda e trupave partizane sllovene fitoi informata relevante se disa elemente Mihailloviqë-Bjellogardistë zhvillojnë bisedime me italianët, me qëllim të organizimit të bandave të armatosura, me ndihmën e italianëve dhe armëve të tyre. Qëllimi i tyre është të hedhin banda në territorin e lirë të Sllovenisë, i cili është nën udhëheqjen demokratike të Frontit Çlirimtar, t'i sulmojnë trupat partizane dhe të nisin luftë vëllavrasëse në dobi të okupatorit. Në përputhje me të gjitha këto përgatitje tradhtare, dhe në interes të mbajtjes së unitetit të sllovenëve dhe arritjeve të mëdha të luftës momentale të popullit slloven për çlirim që solli deri te çlirimi i gjysmës së të ashtuquajturës Krahinë e Lubjanës, Komanda ju përkujton, në formën më të ashpër dhe për herë të fundit që:

1. Secili i cili kryen përgatitje për formimin e cilitdo qoftë grup të armatosur jashtë partizanëve ose i cili nuk ka të bëjë me Komandën e aradheve partizane sllovene, do të pushkatohet në vend.
2. Secili që organizon luftë vëllavrasëse ose kryen ndonjë aksion tjetër i cili do t'i ndihmojë pushtuesit, do të pushkatohet.
3. Urdhrat, të cilat lejojnë mënjanimin e kujtdo qoftë i cili e cenon unitetin e Ushtrisë Popullore Sllovene, në hapësirën e komandës së Aradheve Partizane Sllovene, do t'u dërgohet të gjitha organeve partizane në territorin e çliruar.

Masat e lartpërmendura – të mbështetura në dekretin e Frontit Çlirimtar – janë shqyrtuar nga ana e Komandës së aradheve partizane sllovene me vetëdije të plotë që vetëm përkushtimi më i madh dhe mosbashkëpunimi me elementet të cilat provokojnë luftë qytetare për shkak të interesave të klikës së tyre, mund ta pengojnë popullin slloven ta paguajë çmimin e tradhtisë – kur ata elementë arrijnë sukses në kryerjen e veprave edhe më të përgjakura të tradhtarit në mënyrë të ngjashme siç ka qenë kjo në pjesët tjera të Jugosllavisë – qindra jetë të djemve dhe vajzave të tyre më të mirë.

Vdekje fashizmit – liri popullit!

Në detyrë, 27.05.1942.

Komandant: Peter Strugar, d.v.

Për Komandën e Trupave Partizane Sllovene:

Komisari politik: Jernej Posavec

Slovenski poročevalec, leto III, štev. 22, 2. 6. 1942

Pyetje:

1. Cilat akte të Frontit Çlirimtar shkaktuan mosbesim dhe qëndrim mbrojtës të fraksionit borgjez?

Burimi **4**

FILMAT: ***Dhuna e Mbrojtësve të Vendit dhe Partizanëve***

Shikimi i dy fragmenteve nga dokumentari i RTV të Sllovenisë "Šas vojne" (Kohë lufte) i vitit 2005.

DHUNA E MBROJTËSVE TË VENDIT

Shiheni rrëfimin e Angela Kumshe nga filmi "Kohë lufte" dhe përgjigjuni pyetjeve vijuese:
1. Viktimë e cilës dhunë ishte narratori gjatë kohës së Luftës së Parë Botërore dhe pse?
2. Cilit fat i iku ajo dhe si?
3. Sqaro a kishin të gjithë Mbrojtësit e Vendit qëndrime të njëjta?
4. Për cilën dhunë flet gjithashtu Angela? Jep disa shembuj.
5. Sqaro a pajtoheshin të gjithë me këto veprime?

DHUNA PARTIZANE

Shikoje rrëfimin e Marija Marlotit, e lindur Bradeshko, nga filmi "Kohë lufte" dhe përgjigju pyetjeve vijuese:
6. Viktima të kujt ishin pjesëtarët e familjes Bradeshko, dhe pse?
7. Cili ishte fati i tyre?
8. Sqaro a ishte ky shembull i veçuar apo pjesë e një situate më të gjerë?
9. Sqaro a përjetoi humbje vendi për shkak të viktimave të dhunës partizane pas luftës.

Pas dëgjimit të dy dëshmive, të Angelës dhe Marijës, përpiquni t'i sqaroni dhe t'i jepni arsyet e konfliktit qytetar gjatë kohës së Luftës së Dytë Botërore.

Stergar, Tanja: Posodobitve pouka v gimnazijski praksi. Zgodovina. Razvoj slovenskega naroda v 20. stoletju. Zavod RS za olstvo. Ljubljana 2010. pg. 233

FJALOR SHPJEGUES

FRONTI ÇLIRIMTAR – Organizata e të cilën më 26 prill 1941 në Lubjanë e themeloi Partia Komuniste e Sllovenisë, Socialistët e Krishterë, krahu i majtë i Shoqërisë së Sokolave dhe punëtorëve të kulturës. Në fillim, organizata ishte koalicion i disa grupeve, ndërsa nga viti 1943 Partia Komuniste e morri udhëheqjen mbi organizatën. Kjo organizatë e organizoi rezistencën kundër okupatorit.

VOS – Shërbimi i sigurisë, i themeluar në gusht të vitit 1941, nën komandën e Partisë Komuniste të Sllovenisë. Detyrat e tyre ishin veprimet e sigurimit, likuidimi i bashkëpunëtorëve të okupatorit dhe kundërshtarëve të komunizmit.

PARTIZANËT – Vullnetarë në luftë kundër okupatorit; ushtria e cila e organizoi Frontin Çlirimtar dhe e cila e shfrytëzoi mënyrën guerile të luftimit (sulme ndaj njësive të armikut ose sabotime).

ÇETNIKËT SLLOVENË (GARDA E KALTËR) – Pjesëtarë të ushtrisë së dikurshme jugosllave të cilët në fillim bashkëpunonin me partizanët. Pas sulmit të çetnikëve (nën udhëheqjen e Drazha Mihajlloviqit) ndaj partizanëve serbë, çetnikët sllovenët u ndanë në dy grupe. Njëri, nën udhëheqjen e Jaqke Avshiqit, kaloi në partizanë. Grupi tjetër, nën udhëheqjen e Karel Novakut, mbeti besnik ndaj çetnikëve të Mihaijlloviqit dhe bashkëpunoi me okupatorin. Partizanët sllovenë i quanin brigada të kaltra. Partizanët i nënshtruan pas kapitullimit të Italisë në vitin 1943.

GARDA FSHATARE (MVAC ose GARDA E BARDHË)